

www.gjykataelarte.gov.al



REVISTA DIGITALE

DIALOG JURIDIK

REFLEKTIME GJYQËSORE

2026

Për një dialog juridik të vazhdueshëm: ndryshimi i praktikës gjyqësore, kufijtë kushtetues dhe standardi i arsytimit

(Prononcim për diskutim të hapur në “Dialog Juridik”)

Sokol Sadushi

Kryetar i Gjykatës së Lartë

(ish-gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, profesor i së drejtës)

A mund të ndryshojë një gjykatë e lartë një praktikë të konsoliduar pa cenuar ndarjen e pushteteve dhe pa lëkundur besimin e ligjshëm? Kjo pyetje, që nuk është vetëm teorike, prek çdo jurist, çdo gjyqtar dhe çdo qytetar që kërkon siguri e parashikueshmëri në drejtësi. Për këtë arsye po hap këtë diskutim në Revistën “Dialog Juridik”, duke marrë shkas nga një trajtim akademik që na fton të mendojmë mbi dy qasje: vetëpërmbytjen tekstuale dhe interpretimin e gjallë.

Në vijim të kësaj pyetjeje, ky prononcim synon ti shërbejë debatit, e jo si recencë e një shkrimi. Nxitjen për ta zhvilluar më tej diskutimin e marr nga trajtimi që Prof. Asoc. Dr. Arta Vorpsi i bën problematikës së ndryshimit të praktikës gjyqësore dhe përplasjes shumicë–pakicë në një vendim të rëndësishëm të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane. Pikërisht ky ballafaqim na jep një pikënisje të dobishme për të shqyrtuar, edhe në kontekstin tonë, se cilat janë kushtet që e bëjnë ndryshimin e praktikës njëkohësisht të ligjshëm, të parashikueshëm dhe institucionalisht të disiplinuar.

Debati mbi ndryshimin e praktikës shpesh përshkruhet si takim apo edhe tension mes dy filozofive interpretative, origjinalizmit nga njëra anë dhe të drejtës së gjallë (living law) nga ana tjetër.

Qasja origjinaliste, ose tekstualiste, me të cilën afrohet më shumë linja e pakicës në vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, e vendos pikënisjen e interpretimit të tekstit të normës dhe të kuptimit të tij të disiplinuar, i lexuar në përputhje me vullnetin e ligjvënësit. Për këtë arsye, ajo e sheh me rezervë ndryshimin e praktikës gjyqësore, sepse mund të rrisë rrezikun e tejkalimit të rolit interpretues gjyqësor drejt “krijimit të rregullave”, ndërkohë që një praktikë e konsoliduar ndërton pritshmëri e stabilitet që nuk duhen përmbysur lehtë. Prandaj edhe parimi i ndarjes së pushteteve kërkon vetëpërmbytje, veçanërisht kur preken të drejta themelore. Vlera e kësaj qasjeje është se mbron fort sigurinë juridike, kompetencën e ligjvënësit dhe kufijtë institucionalë të gjyqësorit.

Interpretimi i gjallë i së drejtës (“living law”), me të cilin lidhet më shumë logjika e shumicës, pranon se ligji, sidomos aty ku lë hapësirë interpretimi, duhet të lexohet në mënyrë që të ruajë efektivitetin dhe koherencën e tij në kohë. Në këtë këndvështrim, theksohet se jurisprudenca nuk është ligj. Ajo mund të evoluojë dhe të korrigjohet për të garantuar koherencën e sistemit. Për rrjedhojë, gjykatat e larta kanë një rol njësoj dhe zhvillues, i domosdoshëm për funksionimin e rendit juridik, ndërsa legjitimiteti i çdo ndryshimi të praktikës kushtëzohet nga metodologjia dhe nga një arsytim i shtuar, i aftë të sigurojë parashikueshmëri dhe siguri juridike. Vlera e kësaj

qasjeje qëndron në mbajtjen e rendit juridik të aftë për vetë korigjim, të zbatueshëm dhe të njësuar, pa e bërë stabilitetin një pengesë për drejtësinë dhe koherencën.

Këto dy filozofi nuk duhen parë si “kampet e largëta” të një polemike, por si dy mënyra të domosdoshme për ta mbajtur sistemin në ekuilibër: njëra mbron kufijtë institucionalë dhe sigurinë juridike, ndërkohë që tjetra mbron aftësinë e sistemit për koherencë dhe korigjim.

Ndryshimi i praktikës nuk është thjesht teknikë jurisprudenciale, por një moment ku “testohet” vetë rendi kushtetues. Së pari, ai prek ndarjen e pushteteve, sepse na vendos përpara çështjes thelbësore, nëse gjyqtari mbetet brenda kufijve të interpretimit apo, në fakt, rrezikon të zëvendësojë ligjvënësin duke krijuar normë. Së dyti, ai lidhet me shtetin e së drejtës, sepse çdo ndryshim i standardeve duhet të ruajë parashikueshmërinë dhe sigurinë juridike të palëve; dhe së treti, ai prek kulturën e arsytimit gjyqësor. Ndryshimi bëhet i pranueshëm dhe i besueshëm vetëm kur është i arsyetuar në mënyrë të tillë që të jetë i kuptueshëm, i kontrollueshëm dhe i justifikuar në një rend juridik të matur e koherent.

Në këtë pikë, përplasja “shumicë-pakicë” është produktive. Pikërisht këtu lind vlera e debatit që na detyron të artikulojmë standarde, jo thjesht preferenca.

Qasja e pakicës vepron si “kujtesë institucionale”. Ajo na rikujton se teksti i ligjit dhe zgjedhjet themelore të ligjvënësit nuk mund të zbehen nga preferenca interpretative e momentit; se një praktikë e konsoliduar nuk është thjesht zakon profesional, por krijon pritshmëri dhe stabilitet që kërkojnë respekt të veçantë; dhe se, sa herë preken të drejta themelore, kërkohet një kujdes edhe më i madh për të mos e shndërruar interpretimin në një rregull të ri. Në këtë kuptim, kjo qasje shërben si mburojë ndaj arbitraritetit dhe ndaj rrezikut të “normëbërjes”.

Megjithatë, edhe duke i njohur peshën secilës qasje, standardi i shumicës duket më bindës si udhërrëfyes institucional. Ky standard mbështetet mbi dy shtylla, që e bëjnë ndryshimin të mundur, por edhe të disiplinuar. Së pari, ai kërkon që çdo ndryshim në praktikën gjyqësore të jetë, para së gjithash, një kthesë brenda interpretimit. Ndryshimi nuk legjitimohet nga rezultati që prodhon në një çështje të caktuar, por nga fakti që zgjidhja e re qëndron brenda kuptimit të arsyeshëm të normës dhe mbështetet në metoda të pranueshme interpretimi. Pikërisht këtu ruhet ndarja e pushteteve, sepse gjykata interpreton ligjin pa zëvendësuar ligjvënësin.

Së dyti, aty ku braktiset një praktikë e konsoliduar, standardi i shumicës e ngre lart kërkesën për transparencë dhe përgjegjësi arsyetuese. Gjykata duhet të tregojë qartë pse praktika e vjetër nuk mjafton në koherencë, në zbatim dhe në qartësi. Nga ana tjetër, ajo duhet të bindë se pse zgjidhja e re lidhet më ngushtë me tekstin dhe qëllimin e normës, si ruhet parashikueshmëria dhe siguria juridike, dhe cilat janë pasojat praktike të ndryshimit, në mënyrë që të shmanget pasiguria në zbatim. Ky “arsyetim i shtuar” nuk është formalizëm. Përkundrazi është mekanizmi që e bën ndryshimin të kuptueshëm, të kontrollueshëm dhe, për rrjedhojë, të besueshëm për sistemin dhe publikun.

Debati mbi kufijtë e kontrollit kushtetues dhe rolin e gjykatave të larta ka edhe një dimension institucional. Çdo sistem fiton cilësi kur secila gjykatë e ushtron funksionin e vet kushtetues pa u shndërruar në “shkallë gjykimi” për tjetrën. Një gjykatë kushtetuese ruan profilin e saj kur

ndërhyn vetëm kur çështja ka densitet kushtetues, ndërsa një gjykatë e lartë forcon autoritetin kur prodhon standarde njësuere të qarta dhe arsyetim të disiplinuar të ligjit. Kjo qartësi rolesh është kusht për koherencë, përfundimësi dhe besueshmëri.

Edhe në Shqipëri, gjykatat e larta përballen me nevojën për të ruajtur stabilitetin e praktikës dhe, njëkohësisht, për të korrigjuar mospërputhje, për të njësuar standarde dhe për të garantuar barazi në zbatim. Në këtë realitet, standardi i shumicës është veçanërisht i dobishëm sepse e pranon rolin njësuues/zhvillues të jurisprudencës, duke shmangur “ngrirjen” e së drejtës dhe, nga ana tjetër, e kushtëzon ndryshimin me disiplinë metodologjike dhe arsyetim të shtuar, duke ruajtur sigurinë juridike. Kjo qasje i shërben drejtpërdrejt besimit të publik në gjyqësor. Sa më e qartë është arsyeja e ndryshimit, aq më e parashikueshme është e drejta dhe aq më i fortë është autoriteti i vendimarrjes.

Ky prononcim synon të hapë një rrugë diskutimi dhe jo ta mbyllë atë. “Dialog Juridik” merr kuptim pikërisht kur prodhon reagime, kundërargumente, shembuj nga praktika, pyetje metodologjike dhe propozime standardesh, jo vetëm për këtë temë, por edhe për çështje të tjera ku praktika, ligji dhe kushtetuta takohen.

Prandaj, ftesa ime është e thjeshtë. Të vijojmë këtë dialog me kontribute të strukturuar, qytetare dhe profesionale, sepse vetëm kështu kjo hapësirë fiton funksionin e saj të plotë dhe komuniteti ynë juridik fiton më shumë qartësi, koherencë dhe besueshmëri.